



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1193 Prot.

Tiranë, më datë 29.07.2021

VENDIM  
Nr. 482, datë 28.07.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 28.07.2021:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “Ndërtim Rruga Porto Romano, Durrës” Loti 3, me aplikues znj. Elfjori Zotaj, zhvillues Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Raportin e vëzhgimit arkeologjik të realizuar nga individ i licencuar në arkeologji znj. Elida Zeqo Miraj:
  - Të propozohet spostimi i gjurmës së re të rrugës, në largësi nga objekti pasuri kulturore “monument kulture kategoria e I-rë” me emërtimin në listën e objekteve pasuri kulturore “Muret e Porto Romanos”, shpallur me Urdhër Nr. 1886, datë 10.06.1973 nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Arta DOLLANI

